

20222693999

**АГЕНЦИЈА ЗА СУПЕРВИЗИЈА НА КАПИТАЛНО ФИНАНСИРАНО ПЕНЗИСКО  
ОСИГУРУВАЊЕ**

Në pajtim me nenin 101, paragrafi (4), të Ligjit të Sigurimit të Detyrueshëm Pensional me Financim Kapital (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/2010, 171/2010, 36/2011, 98/2012, 13/2013, 164/2013, 44/2014, 192/2015 30/2016, 21/2018 dhe 245/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 180/2019 dhe 103/2021) dhe nenin 120, paragrafi (4), të Ligjit të Sigurimit Pensional Vullnetar me Financim Kapital (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 07/2008, 124/2010, 17/2011 dhe 13/2013 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 103/2021), Këshilli i ekspertëve të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Financimit Kapital të Sigurimit Pensional në seancën e mbajtur me datë 29.11.2022, miratoi

**RR E G U L L O R E  
PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES SË  
PERSONAVE JURIDIKË VENDORË PËR KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË LETRAVE  
ME VLERË**

**Neni 1**

Në Rregulloren për procedurën e përzgjedhjes së personave juridikë vendorë për kryerjen e shërbimeve me letra me vlerë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 110/2013 dhe 47/2014 dhe 32/2018) në nenin 3, pika a) fshihet.

Pikat b) dhe c) bëhen pika a) dhe b).

**Neni 2**

Në nenin 4, paragrafi (1), pas fjalës: "vlера" në rreshtin e katërt vendoset një pike, ndërsa fjalët: "të cilat plotësojnë kriterin e nenit 3, paragrafi (1), pika a) të kësaj rregulloreje", fshihen.

**Neni 3**

Në nenin 7, paragrafi (1), pas fjalës: "sigurimi" shtohen kllapa dhe fjalët: "(në tekstin e mëposhtëm: Agjencia)".

Në paragrafët (2) dhe (3) fshihen fjalët: "për mbikëqyrje të sigurimit pensional me financim kapital".

**Neni 4**

Në nenin 8, paragrafi (1), pika a), pas fjalës: "Republika" shtohet fjala: "e Veriut".

**Neni 5**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e nesërme nga shpallja në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nr. 01-1637/10  
5.12.2022  
Shkup

Këshilli i Ekspertëve  
Kryetari,  
**Maksud Ali**, d.v.